

MARRËVESHJA E TRANSFERIMIT TË KUOTAVE

Sot më datë 14 Janar 2022 (dy mijë e njëzetë e dy) në Tiranë, palët e mëposhtme lidhin këtë Marrëveshje të Transferimit të Kuotave (“Marrëveshja”) :

- Z.Olti Kaja , shtetas shqiptar, lindur më datë 07/08/1995, identifikuar me numër personal J50807097I, zotërues i 50% të kapitalit të Shoqërisë “STOCKHOLM COFFEE & LOUNGE” Shpk; shoqëri e themeluar dhe që ekziston sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar pranë QKB me NIPT M01307015N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, referuar më poshtë si “Dhuruesi”,

Dhe


- Z. Ferhat Kaja, shtetas shqiptar, lindur më datë 17/03/1994, pajisur me numër personal identifikimi J40317116H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, referuar më poshtë “Përfituesi”.

Përfituesi dhe Dhuruesi në vijim do të referohen bashkërisht si “Palët” dhe veçmas si “Pala”.

MEQËNËSE:

- Dhuruesi është zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 50% të totalit të kapitalit të Shoqërisë “STOCKHOLM COFFEE & LOUNGE” Shpk me NIPT M01307015N, më poshtë referuar si “Shoqëria”.
- Dhuruesi dëshiron t’i dhurojë kuotën e tij Përfituesit, që përfaqëson 50% të totalit të kapitalit të Shoqërisë, dhe Përfituesi dëshiron të pranojë nga Dhuruesi kuotën, sipas kushteve dhe afateve të kësaj marrëveshje.

Ndaj, duke marrë në konsideratë marrëveshjet e përbashkëta këtu, palët bien dakord si më poshtë vijon:



NENI 1
OBJEKTI I MARREVESHJES

Në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj marrëveshje, Dhuruesi i dhuron përfituesit Z. Ferhat Kaja kuotën që ai zotëron, e barazvlefshme me 50% të totalit të kapitalit të Shoqërisë.

NENI 2
CMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES

2.1 Meqënëse në këtë rast kuota po dhurohet, nuk do të ketë asnjë pagesë.


NENI 3
MARREVESHJET, PERFAQËSIMET DHE GARANCITË E PALËVE

3.1 Në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje Dhuruesi garanton se:

1. Është zotëruar ligjor dhe i vërtetë i kuotës.
2. Ka të drejtë të ushtrisë të gjitha të drejtat mbi kuotën.
3. Kuota është shlyer në mënyrë të rregullt dhe nuk ka asnjë peng apo barrë fiskale.
4. Dhuruesi ka të gjitha të drejtat ligjore dhe të plota për të lidhur dhe kryer transaksionet e përshkruara në këtë marrëveshje.

3.2 Në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, Përfituesi garanton se:

1. Nuk ka asnjë pengesë ligjore për të lidhur këtë marrëveshje.
2. Ka të gjitha të drejtat dhe autorizimet që të përfundojë transaksionin e parashikuar në këtë marrëveshje.
3. Kjo marrëveshje përbën një detyrim ligjor të vlefshëm dhe të zbatueshëm për përfituesin.
4. Përfituesi garanton Dhuruesin se garancitë janë të vërteta dhe të sakta.



NENI 4
TE NDRYSHME

4.1 Kjo marrëveshje përbën të gjithë marrëveshjen midis palëve dhe të gjitha premtimet përfaqesimet, kuptimet, garancitë, në lidhje me objektin e kësaj marrëveshje. Asnjë ndryshim nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dy palët.

4.2 Nuk do të hiqet dorë as nuk do të falet mospërmbushja e ndonjë kushti apo neni të kësaj marrëveshje përveç se me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

4.3 Nëse ndonjë prej neneve të kësaj marrëveshje rezulton i pavlefshëm, i paligjshëm apo i pazbatueshëm ai do të ndryshohet aq sa të jetë e nevojshme për ta bërë të vlefshëm, të ligjshëm apo të zbatueshëm. Kur kjo nuk është e mundur ai nën do të hiqet nga marrëveshja dhe dispozitat e tjera të saj do të jenë në fuqi të plotë.

4.4 Kjo marrëveshje do të jetë e detyrueshme për palët dhe pasardhësit dhe të transferuarit e lejuar të tyre.

4.5 Çështjet që nuk janë parashikuar në këtë marrëveshje ose që mund të rrjedhin prej saj do t'i nënshtrohen legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë që është ligji i zbatueshëm i Marrëveshjes.

4.6 Çdo konflikt që lind midis palëve në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj marrëveshje dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim nga palët do të zgjidhet nga Gjykata e Tiranës.

4.7 Kjo marrëveshje nënshkruhet në 3 kopje origjinale.

Përfituesi

Dhuruesi

